



Datë: 18.06.2025
Numër Protokolli: 4667/2025

A.nr.353/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari, kryetare, Ardita Haxhnikaj -Demi dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Rushit Kajtazi, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.353/2025, të datës, 24.02.2025, të parashtruar nga ankuesja A.L, kundër organit të punësimit: Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 si dhe në mbështetje me dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 18.06.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa A.nr.353/2025, e datës 24.02.2025, e parashtruar nga ankuesja A.L.

II. Anulohet në tërësi procedura e rekrutimit e shpallur sipas konkursit të datës 20.12.2024 me numër të Referencës RN00016123 për pozitën “*Zyrtar për Integrime Evropiane*” e shpallur nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, dhe çdo veprim tjetër që rrjedh nga kjo procedurë e rekrutimit.

III. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm dhe Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, që të ndërmerr të gjithë veprimet e nevojshme me qëllim të zbatimit të këtij vendimi si në pikën **II** të dispozitivit, në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e pranimi të këtij vendimi.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesja A.L. (në tekstin e mëtejme referuar Ankuesja), më datë 24.02.2025 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 1895/2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Procedurës së rekrutimit sipas konkursit me numër reference RN00016123, për pozitën “*Zyrtar për Integrime Evropiane*”, të zhvilluar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar Këshilli), bazuar në Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 20.03.2025 ka

proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankueses në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, ndërsa Këshilli më datë 08.04.2025 ka pranuar përgjigje në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejshëm referuar: Kolegji i Këshillit) pas konstatimit se ankesa është e pranueshme në kuptim të dispozitave të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi për shqyrtimin e të njëjtës, kështu që për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 1185/2025, të parashtruar nga ankuesja më datë 24.02.2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Njoftimi i datës 06.02.2025, i nxjerr nga Njësia e Burimeve Njerëzori e MFPT; Lista përfundimtare e Vlerësimit të kandidatëve; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 20.03.2025, dërguar përmes emailit nga Y.F, për K.D; Përgjigjen në ankesë me numër protokolli 353/2025, e datës 08.04.2025; Vendimi me numër protokolli 342/2025, i datës 03.02.2025, për Themelimin e Komisionit të Pranimit; Akt Emërimi i datës 04.05.2024, për R.V; Akt Emërimi i datës 04.05.2024, për D.A; Akt Emërimi i datës 16.08.2024, për H.R.R; Akt Emërimi i datës 30.09.2024, për Y.S; Akt Emërimi i datës 04.05.2024, për L.H; Testin me shkrime për V.T; Testin me shkrim për A.R; Testin me shkrim për A.L; Kopjen e konkursit me Nr. Ref. RN00016123 i datës 20.12.2024 për pozitën Zyrtar për Integritet Evropianë; Listën e aplikanteve të aprovuar dhe të refuzuar; Njoftimin e datës 13.02.2025 për shpalljen e kandidateve fitues; Kërkesë e dërguar nga njësia përkatëse të ZKA dhe aprovimin e saj; Akt Emërimet e anëtarëve të Komisionit të Pranimit Testin me shkrime të ankuese A.L; Njoftimin e datës 06.02.2025 për kandidate që kanë kaluar fazën e verifikimit paraprak; Renditjen Përfundimtare të kandidateve e datës 12.02.2025; Listën përfundimtare të vlerësimit të kandidateve e datës 13.02.2025; Njoftimet e datës 11.02.2025 për intervistën me gojë; Formularët e vlerësimit të eses; Formularët e vlerësimit individual për kandidatin fitues; Aplikacionin e datës 26.12.2024 të ankuese A.L të bashkangjitur me gjitha dokumentet e aplikimit; Aplikacionin e datës 10.01.2025 të kandidate fituese V.T të bashkangjitur me dokumentet e aplikimit; Aplikacionin e datës 06.01.2025 të kandidate fituese A.R të bashkangjitur me dokumentet e aplikimit;

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të dorëzuara nga palët në procedurë ka gjetur se ankesa është e bazuar, **sepse**:

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, më datë 20.12.2024, ka shpallë konkursin publik me numër reference RN00016123, Grupi i Administrimit të Përgjithshëm, gjegjësisht për dy(2) pozita të punës *Zyrtar për Integritet Evropianë* -Klasa Profesional 2, me afat aplikimi nga data 21.12.2024 deri më datën 19.01.2025.

Rrjedhimisht, nga shkresat e lëndës rezulton se në konkursin përkatës të punësimit kanë aplikuar gjithsejtë 103 kandidatë, ndërsa prej tyre kriteret e konkursit i kanë plotësuar dhe kanë hyrë në listë të ngushtë 52 kandidatë në mesin e tyre edhe ankuesja, e cila ka marrë pjesë në fazën e testit me shkrim ku e njëjta ka grumbulluar 48 pike dhe e njëjta nuk kishte arritur të kalojë fazën tjetër në intervistën me gojë, ndërsa sipas Njoftimit të datës 13.02.2025, të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Financave Punës dhe Transfereve, rezulton se kandidate fitues janë shpallur V.T me gjithsejtë 86.4 pikë dhe A.R me gjithsejtë 80.4 pikë të arritura nga kjo procedurë rekrutimit respektivisht janë shpallur kandidate fituese për pozitën e punës „Zyrtar për Integritet Evropianë në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve,

Ankuesja, në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër aktit përfundimtar të kësaj procedure rekrutimi, me pretendimin për shkak shkeljeve procedurale dhe hartimet të pyetjeve janë jo profesionale duke pretenduar se nuk janë respektuar standardet e cilësisë për rikthimin e kandidateve dhe kërkon nga Këshilli të shqyrtoj organizimin e

këtij konkursi dhe e njëjta kërkon që Këshilli të vendosë në baze të kompetencave të veta në lidhje me këtë procedurë e rekrutimit.

Kolegji i Këshillit, mbështetur në mandatin kushtetues dhe ligjor lidhur me sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, e ndërlidhur me nenin 86 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: *“Organi publik përcakton, në mënyrë të pavarur, llojin dhe shtrirjen e shqyrtimit administrativ, si dhe vlerëson nëse një fakt apo rrethanë është e nevojshme për zgjidhjen e çështjes”*, lidhur me këtë çështje ankimore ka analizuar shpalljen Konkursit publik me numër reference RN00016123, respektivisht për (2) pozita të punës *Zyrtar për Integritet Evropianë* -Grupi i Administrimit të Përgjithshëm, Klasa-Profesional 2, dhe si rrjedhojë nga analizimi i të njëjtit ka gjetur se kërkesa të përgjithshme formale në procedurën përkatëse të rekrutimit kanë qenë, **Arsimimi i kërkuar:** Diplomë e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor). **Përvoja e punës e kërkuar:** se paku (1(vite provoj punë sqepaku në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së Lirë të punës.

Kolegji i Këshillit, përpara se të lëshohet në shqyrtimin e pretendimeve të tjera ankimore të ankuesit, mori për bazë Vendimin Nr.08/226 e të datës 23.10.2024 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, ku përmes pikës I të dispozitivit është aprovuar Katalogu i Vendeve të Punës për Shërbimin Civil, ndërsa sipas pikës VI të dispozitivit të të njëjtit vendim përcaktohet fakti se vendimi në fjalë hynë në fuqi ditën e publikimit në gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, dhe për rrjedhojë u konstatua se Vendimi Nr.08/226 i datës 23.10.2024 i Qeverisë së Republikës së Kosovës, është publikuar në gazetën zyrtare me datë 23.10.2024, nga rrjedh se i njëjti ka hyrë në fuqi me datë 23.10.2024, ndërsa konkursi në fjalë është shpallur pasi ka hyrë në fuqi Katalogu i Vendeve të Punës për Shërbimin Civil, përkatësisht më datë 20.12.2024 pra pas hyrjes në fuqi të Katalogut të Vendeve të Punës për Shërbimin Civil.

Duke marrë për bazë Katalogun e Vendeve të Punës për Shërbimin Civil, të aprovuar sipas Vendimit Nr.08/226 të datës 23.10.2024, Kolegji i Këshillit konstatoi se pozita *“Zyrtar për Integritet Evropianë”*, identifikohet me kodin SHC-1151 në kuadër të grupimit Grupi të Shkencave Shoqërore, kurse fusha e kërkuar e arsimit është përcaktuar sikurse sipas Rregullores (QRK) Nr. 06/2024 Për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil gjegjësisht është përcaktuar: *Diplome Universitare nga Fakulteti Juridik, Ekonomik (pa specifikim), Sociologji, Antropologji, Filozofi, Histori, Shkenca Politike, Psikologji, Punë Sociale, Gjeografi, Administratë Publike.*

Në këtë kuptim, duke u bazuar në dispozitat e aplikuara të nenit 19, nenit 20 si dhe nenit 31 paragrafi 1 dhe 2 Rregullores (QRK) Nr. 06/2024 Për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil ku përcaktohet se: **“19. Kërkesat e përgjithshme formale, përfshijnë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës që janë të domosdoshme për kryerjen me sukses të detyrave dhe përgjegjësi; 20.1. Kriteret specifike, për pozita të caktuara, mundet të përcaktohen vetëm gjatë procesit të miratimit të përshkrimit të vendit të punës. 20.2. Kriteret specifike mund të përcaktojnë kualifikimin, licencimin dhe/apo certifikimin e posaçëm që kërkohet për pozitën përkatëse. 30.1. Me qëllim të lehtësimit të procesit të klasifikimit dhe grupimit të vendeve të punës për kategorinë profesionale, hartohet katalogu i vendeve të punës në pajtim me këtë Rregullore dhe miratohet nga Qeveria, me propozim të Ministrisë Përgjegjëse për Administratë Publike. 30.2. Katalogu i vendeve të punës përmban emërtimin e pozitës, kategorinë, klasën, grupin dhe kriteret e përgjithshme si dhe përshkrimin e vendit të punës për çdo pozitë.”**, si rrjedhojë Kolegji i Këshillit konstatoi se Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, shpalljen e konkursit me numër reference RN00016123 të datës 20.12.2024 kategoria profesional 2 për pozitën *“Zyrtar për Integritet Evropianë”* e ka shpallur në kundërshtim me

Katalogun e Vendeve të Punës për Shërbimin Civil, i aprovuar dhe i cili ka hyrë në fuqi me datë 23.10.2024 sipas Vendimit Nr.08/226 të Qeverisë së Republikës së Kosovës si dhe në kundërshtim me dispozitat e cekura si më lartë të Rregullores (QRK) Nr. 06/2024 Për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, ndërlidhur me Shtojcën Nr.2: Grupet Tip të administrimit të përgjithshëm dhe posaçëm, pasi që pozita në fjalë “Zyrtar për Integritet Evropianë” hynë në kuadër të grupimit **Grupi i Shkencave Shoqërore**, ndërsa sipas konkursit pozita në fjalë është përfshirë në grupin Administrim i Përgjithshëm, dhe për rrjedhojë pozitës në fjalë i janë ndryshuar edhe kriteret e përcaktuara të kualifikimit arsimor të cilat janë të përcaktuara sipas rregullores së lartcekur dhe Katalogut të Vendeve të Punës për Shërbimin Civil, nga rrjedh se procedura e rekrutimit është zhvilluar në kundërshtim me nenin 7 paragrafi 1 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, me nenin 19 dhe nenin 31 paragrafi 1 dhe 2 Rregullores (QRK) Nr. 06/2024 Për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil.

Andaj, duke marrë për bazë konstatimet e dhëna si më lartë, dhe meqenëse Kolegji i Këshillit konstatoi se në këtë procedurë të rekrutimit shkeljet janë evidentuar që nga shpallja e konkursit të datës 20.12.2024, ashtu që nuk janë përfillur kriteret e aprovuara lidhur me grupimin e pozitës, duke ndryshuar më pastaj edhe kriteret për fushën e kualifikimit arsimor për pozitën „Zyrtar për integritet evropianë,” duke u bazuar në dispozitat e nenit 53 dhe nenit 55 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të kthimit të ligjshmërisë vendosi sikurse në dispozitivin e këtij vendimi që të anuloi konkursin e datës 20.12.2025 me numër të Referencës RN00016123 për pozitën „Zyrtar për integritet evropianë,” në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve si dhe të shfuqizoi çdo akt dhe veprim tjetër procedural që ndërlidhet me konkursin në fjalë.

Kolegji i Këshillit thekson faktin se meqenëse konstatoi paligjshmërinë e aktit të shpalljes së konkursit në fjalë, nuk u lëshua në shqyrtimin e pretendimeve të tjera ankimore të ankueses të parashtruara si në ankesën e datës 24.02.2025, pasi që konstatimi nëse pretendimet janë apo jo të bazuara nuk do ta ndryshonin natyrën vendimmarrëse të kësaj çështje administrative, ndërsa ankesa e ankueses është aprovuar vetëm për arsyet e dhëna si në arsyetimin e këtij vendimi.

Thënë si më sipër, e në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.353/2025

Rushit Kajtazi

Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses A.L;
- Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve (Sekretarit të Pergjithshëm dhe dhe Menaxheres së Burimeve Njerzore); dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.